




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministri of Internal Affairs

Agjencia e Menaxhimit Emergjent
Agencija o Upravljanju Vanrednim Situacijama
Agency of Emergency Management

NJËSIA PROFESIONALE PËR ZJARRFIKJE DHE SHPËTIM
SHTIME

REFERENCË :	
DATË :	09.11.2018
PËR/ZA/TO :	Gazmend Ademaj, Zyra e Informimit
Cc :	Naim Ismajli, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM :	Bajram Gashi, Komandant i NJPZSH-së
TEMA /SUBJEKAT/SUBJECT	Njoftim

Duke ju referuar shqetësimeve të banorëve për ndotjen e ambientit, që ka të bëjë pikërisht me djegien e mbeturinave, dhe në përgjigje të shqetësimeve të banorëve kemi marrë masa preventive për të mbatjur nën kontroll situatën duke bashkëpunuar ngusht me të gjitha institucionet përgjegjëse lokale.

Sic jeni në dijeni, ditët e fundit është shtuar problematika lidhur me djegien e mbeturinave në vende të hapura pranë objekteve dhe qendrave të banuara, si dhe në pjesë tjera të teritorit të komunës sonë, duke u kthyer kështu në një rrezik serioz për shëndetin e banorëve pranë tyre. Informacionet e fundit tregojnë se vendet-lokacionet më problematike në këtë drejtim janë: në qytetëzën e Shtimes dhe në disa vendbanime të komunës sonë.

Nisur nga kjo që u tha më sipër, kemi marr masa preventive për të mbajtur nën kontroll situatën në të gjithë territorin e komunës sonë. Për këtë, jemi duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet përgjegjëse lokale, me qëllim ndalimin e zjarreve në vende të hapura publike, për të bërë zvogëlimin e ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor si dhe minimizimi ose ndalimin e atyre aspekteve ekonomike dhe aktiviteteve të tjera që përbëjnë një rrezik të madh për shëndetin e njeriut dhe mjedisit.

Po ashtu, në ditët në vijim së bashku me strukturat e Policisë në Shtime, do të komunikojmë edhe me kompanitë e kontraktuara për pastrimin e qytetit/vend-banimeve, për t'i dhënë fund një fenomeni të tillë të rrezikshëm.

NJPZSH-ja në Shtime kërkon nga të gjithë qytetarët e Shtimes që të ndihmojnë në parandalimin e këtyre rasteve, mbrojtjen e pronës dhe mjedisit duke raportuar Inspektoratin Komunal ose Policinë e Kosovës në Shtime me informata dhe fotografi të personave që hedhin mbeturina në vende të pacaktuara dhe bëjnë zjarrvënie të qëlimshme.